

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Biljana Rexhiq kryetare e kolegjit, Dalip Bega dhe Mejreme Zekaj anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtoresh profesionale Sebahate Hoti, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga mbrojtësi i të pandehuri Boban Predrag Filipović, avokati Zharko Gajić kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr.regj.45286/2013, të dt. 12.09.2013, në bazë të nenit 31 al.3-39 dhe 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 08.10.2013, merr

## AKTVENDIM

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

**ABROGOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr. regj. 45286/2013, të dt. 12.09.2013, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim të procedurës.


Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

## Arsyetim

Gjykata Themelore-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Nr. regj. 45286/2013, të dt. 12.09.2013, të pandehurin Boban Predrag Filipović nga fshati Kuzmin, Komuna e Fushë Kosovës, e ka shpallë përgjegjës:

Sepse si Zyrtar i Lart Publik, Nënkrjetar i Komunës së Fushë Kosovës, nuk i ka ven në dispozicion të dhënat e kërkuara me shkrim nga Agjencia në afatin kohor sipas Ligjit nr.04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lart publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, me ç, veprim i pandehuri ka bërë kundërvajtje nga neni 15 par.3 të Ligjit nr.04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, për të cilën kundërvajtje të pandehurit i shqiptoj gjoja në shumë prej 1000 Euro. Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 15 Euro.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehuri Boban Filipović, av. Zharko Gajić, për shkak të shkeljes esenciale së dispozitave procedurale, aplikimit të gabuar të ligjit, vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike, dhe vendimit mbi dënimin, në arsyetimin e ankesës shton: dispozitivi i aktvendimit është i pa qartë dhe i papërcaktuar, nga e njëjta nuk shihet se kur i pandehuri e ka krye kundërvajtjen, cilën dit, vend dhe mënyrën, elemente këto që e formojnë figurën e veprës kundërvajtëse, pastaj dispozitivi i aktvendimit është në kundërshtim me arsyetimin e aktvendimit, në arsyetim thuhet se i pandehuri ka plotësuar formularin nr.A-13, që do të thotë ka plotësua formularin e duhur, në arsyetimin e aktvendimit ceket se gjoja Agjencia me dt. 22.08.2013, të pandehurit ja ka dërguar njoftimin që në afat prej 15 ditësh të përmirësoj gabimet, mirëpo nuk ceket data-koha kur i pandehuri e ka pranua njoftimin, për ndryshe i pandehuri nuk e ka pranuar njoftimin e Agjencisë, pastaj gjykata me rastin e dërgimit të ftesës të pandehurit për marrje në pyetje nuk ja ka dërgua kopjen e kërkesës për inicim të procedurës. Me rastin e marrjes në pyetje i pandehuri nuk është udhëzua për të drejtën e angazhimit të mbrojtësit ligjor-avokatit. Propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar ndërsa aktvendimi i kundërshtuar të ndryshohet dhe i pandehuri të lirohet nga përgjegjësia dhe dënimi i shqiptuar ose të priset dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.





Kolegji i Gjykatës së Apelit-Divizioni për Kundërvajtje, pas vlerësimit të thënieve në ankesën e paraqitura, aktvendimin e goditur, si dhe shkresat tjera të lëndës konstatoi se ankesa është e bazuar, ndërsa aktvendimi i goditur abrogohet dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së pare në rivendosje.

Kolegji vendosi për abrogimin e aktvendimit të ankimuar për këto shkaqe:

Gjykata e shkallës së pare me rastin e zhvillimit të procedurës kundërvajtjese nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjendjen faktike, sepse:

- Gjyqtari me rastin e marrjes në pyetje të pandehurin, nuk e ka sqarua-pyetur të pandehurin a ka pranuar Njoftimin e Agjencionit, të datës 22.08.2012.

- Nuk ka marr në pyetje punëtorin e autorizuar të Agjencisë, i cili kishte me sqaruar çështjen e dorëzimit të Formularit dhe Njoftimit, të pandehurit.

- Në shkresat e lëndës nuk ka prova të sigurta se i pandehuri e ka pranuar Njoftimin e Agjencisë të datës 22.08.2012, sa i përket flet kthesës të postës, të cilën Agjencia ja ka bashkangjitur shkresave të lëndës, nga e njëjta nuk shihet se cili dokument ju ka dërguar të pandehurit, formulari, njoftimi, apo ndonjë tjetër dokument.

- Nga dispozitivi i aktvendimit nuk shihet se për cilin vit i pandehuri është dashtë ta deklaroj prejardhjen e pasurisë.

- Në arsyetimin e aktvendimit thuhet se i pandehuri ka plotësuar formularin nr.A-13, që do të thotë ka plotësuar formularin e duhur dhe nuk ka krye kundërvajtjen për të cilën është shpall fajtor dhe është dënuar, andaj për këto shkaqe aktvendimi si i tillë nuk mund të qëndroi por duhet të bëhet plotësimi i procedurës.

Sa i përket pretendimeve të mbrojtësit të pandehurit në ankesë, se i pandehuri me rastin e marrjes në pyetje, nuk është njoftuar me të drejtën e ti ligjore, për mundësin e angazhimit të mbrojtësit, një konstatim i tillë nuk qëndron, sepse, nga procesverbali i marrjes në pyetje të pandehurin, shihet se i pandehuri është njoftuar për mundësinë e angazhimit të avokatit dhe deklarimi i ti se mbrojtjen do ta bëjë vet.

Në plotësimin e procedurës gjykata e shkallës së parë duhet të veproi sipas vërejtjeve të cekura më lartë, e pas nxirjes së këtyre provave dhe vlerësimit të tyre një nga një, dhe në tersi, të vendos lidhur me këtë çështje kundërvajtjese, duke nxjer aktvendim të ri dhe të bazuar në ligj, diapozitivi i të cilit aktvendim do ti përmban faktet dhe rrethanat të cilat e formojnë tiparin e kundërvajtjes si dhe ato prej të cilave varret aplikimi i dispozitës Ligjore sikurse parashihet me nenin 205 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, gjithashtu gjykata duhet të merr parasysh edhe pretendimet e të pandehurit në ankesën e parashtruar.

Më sa u tha më lart konform nenit 220 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

**KA. nr.1037/2013, të dt. 08.10.2013.**

Procesmbajtësja  
Sebahate Hoti



KRYETARJA E KOLEGJIT  
Biljana Rexhiq